

UDHËZIM
Nr.31, datë 26.5.2009

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 “PËR AKCIZAT”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në pikën 50.1 të udhëzimit nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat”, i ndryshuar, shtohet germa “e”, me këtë përmbajtje:

e) kur sasia e pullave të tërhequra;

- për importimin e pijeve alkoolike, nuk është ngjitur në njësinë e ambalazhimit (të papërdorura), për arsye të falimentimit, mbylljes së aktivitetit, zgjidhjet së kontratës me firmat nga importohen pijet alkoolike etj.;

- për prodhimin e pijeve alkoolike, nuk është ngjitur në njësinë e ambalazhimit (të papërdorura), për arsye të falimentimit, mbylljes së aktivitetit etj.

2.Në pikën 50.2 shtohet germa “e” me këtë përmbajtje:

e) sigurohet konfirmimi i blerjes së sasisë së pullave me akcizë, pagesës së akcizës, të sasisë së importeve të pijeve alkoolike të pajisura me pullë, dhe gjendja e sasisë së pullave të papërdorura, kjo e fundit për prodhimin e pijeve alkoolike, mbasi janë ngjitur në gjithë sasinë e mallrave gjendje mbas falimentimit ose mbylljes së aktivitetit.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCVE
Ridvan Bode